



STATUT
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZ
“VËLLEZËRIT HYSA ” - SH.P.K.

KREU I
THEMELIMI , EMRI , OBJEKTI , KOHËZGJATJA , SELIA DHE ADRESA
E FAQES SË INTERNETIT

Neni 1
DATA E THEMELIT , EMRI DHE THEMELUESI


Sot me datë **10.10.2011** (Dymijënjëmbëdhjetë),ditë e Hëne ,Unë ,Themeluesi,
Artan HYSA ,i biri i Femiut , lindur me 06.11.1967 në Borovjan /Dibër, banues në Lagjen
“Gjok Doçi” të Qytetit Peshkopi,zotërues i Kartës së Identitetit me **Nr.030035274**,mbi bazën e
Aktit të Themelimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë kam krijuar STATUTIN E RI për
SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR me emrin : **“VËLLEZËRIT HYSA ” -**
SH.P.K..të pështatur sipas ligjit Nr.990I,date 14.04.2008,”Për Tregtarët dhe Shoqëritë
Tregtare , për të zhvilluar aktivitetet tregtar në fusha të ndryshme.
Ajo është një person juridik shqiptar që ushtron aktivitetet privat në të gjithë territorin e
Republikës së Shqipërisë dhe është regjistruar sipas ligjit me Vendimin e Gjykatës Tiranë
Nr.36040,datë28/06/2006.

Neni 2
OBJEKTI I AKTIVITETIT EKONOMIK DO TË JETË :

a) Në fushën e ndërtimit në kategoritë e mëposhtme :

- Ndërtim pike karburanti me të gjitha shërbimet e tjera ndihmëse si (bar-kafe,servis garazh) e të tjera të ngjashme,
- Punime gërmimi në tokë,
- Ndërtime civile dhe industriale,
- Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale,veshje fasadash,
- Rrugë,autostrada,mbikalime,hekurudha,tramvaje,metro,pista aeroportuale,
- Ujësjellsa,gazsjellsa,vajsjellsa,vepra kullimi e vaditje,
- Ndërtime për nënstacione,kabinat e transformatorëve,linja të TN e T/Mesëm dhe shpërndarjen e energjisë,
- Punime për prishjen e ndërtimeve,
- Impiante hidrosanitare e kuzhina,lavanteri,mirëmbajtja e tyre,
- Impiante ngritëse dhe transportues(shkallë lëvisëse,transportues),
- Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to,rifiniturë me materiale druri,plastik,metalik e xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese,
- Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut,
- Sinjalistika rrugore jo ndriçuese,
- Barriera dhe mbrojtje rrugore,
- Ndërtime parafabrikat beton/arme,struktura metalike dhe druri,
- Impiante teknologjike,termike dhe të kondicionimit,
- Impiante dhe linja telefonie e telekomunikacioni,
- Impiante të brendëshme elektrike,telefoni,radiotelefoni,TV-ni etj.
- Punime topogjeodezike,



- 
- Punime nëntoksore, ura e vepra arti,
 - Diga dhe tunele hidroteknike,
 - Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë,
 - Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime,
 - Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike,
 - Punime të inxhinjerisë së mjedisit,
 - Punime strukturore speciale,
 - Punime mbi shina dhe traversa,
 - Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore,
 - Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimi i tij,
 - Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane,
 - Sistemet kundra zhurmës në infrastrukture,
 - Shpime gjeologo-inxhinjerie, puse e shpime për ujë,

b) Në fushën e tregtisë në drejtimet e mëposhtme :

- Tregtimin me pakicë për të gjitha llojet e karburanteve, vajrave lubrifikantë etj,
- **Import-Eksport, tregtimi i artikuljeve të ndryshëm i të gjitha llojeve me shumicë e pakicë,**
- **Tregtimi i artikuljeve të ndryshëm industrialë,**
- **Tregtimi i artikuljeve të ndryshëm ushqimorë,**
- Tregtimi i artikuljeve të ndryshëm bujqësor e blektoralë,
- Tregtim i fruta e perimeve të të gjitha llojeve,
- Tregtim automjetesh të çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe tregtimi i pjesëve të këmbimit për to,
- Tregtim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronikë, higjieno-sanitare, prodhime qeramike, prodhime të artizanantit etj,
- Tregtim bimësh mjeksore e eterovajore, plehrash kimike, pesticidesh, etj,
- Tregtim i konfeksioneve e tekstileve, i artikuljeve të farmaceutikës e kozmetikës, i këpucëve të çdo lloji, i galanterisë dhe artikuljeve të lëkurës e të ngjashme me to,
- Tregtim pijesh alkolike dhe jo alkolike,
- Hapje autoshkolle,
- Hapje pike lavazhi dhe servisi për automjete,

c) Në fushën e transportit, në drejtimet e mëposhtme :

- **Transport mallrash të të gjitha llojeve brenda e jashtë vendit,**
- Transport pasagjerësh brenda e jashtë vendit,

d) Në fushën e përmirsimit mineralar, punimeve të ndryshme dhe përmirsimit njëditor, në drejtimet e mëposhtme :

- Aktivitet mineralar në nxjerrje, përpunim e pasurim të mineralit të kromit, të ferrokromit, si dhe tregtim e eksportim të tyre, transport dhe ndërmjeticim për tregje të mineralit të kromit, prodhim koncentratit,
- Shpime nëntoksore,
- Shfrytëzim mineralesh të ndryshme,
- Hapje e shfrytëzim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendra pushimi e kurative,
- Punime të duraluminit e tregtimi i tyre,
- Punime druri, tregtim prodhimesh të ndryshme druri si : orendi, dyer, dritare, etj.




- HPK
- Përmirsimi i pyjeve, shfrytëzimi, përpunimi dhe tregtimi i lëndës drusore, mbrojtja dhe përmirsimi i livadheve e kullotave, mbrojtjen e pyjeve nga zjarri e dëmtuesit, përmirsim i florës e faunës së zonave,
 - Veprimtari në studim, projektim dhe zbatim punimesh në fushën e pyllëzimit dhe përmirsimit pyjor, mbarështrim pyjesh, mbarështrim i faunës, mbarështrim i florës, mbarështrim i kullotave dhe livadheve, ndërtim dhe meremetim i veprave për sigurimin e ujit të pijshëm në kullota e livadhe,
 - Punime të ndryshme alumini, llamarine, punime ulluqesh e të ngjashme dhe tregtimi i tyre,
 - Punime hekuri, lysterje dhe tregtimi i tyre,
 - Shtrime pllakash, lysterje ndërtesash,
 - Tregtim i të gjithë produkteve të hekurit, aluminit dhe llamarinës,

Neni 3

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria “.” do të ketë një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike me një kufi të pacaktuar mbi 15 vjet dhe mund të shpërbehët në çdo kohë për çfarëdo shkak.

Neni 4

SELIA, ADRESA E FAQES SË INTERNETIT DHE ADRESA ELEKTRONIKE

Shoqëria “VËLLEZËRIT HYSA”- SH.P.K. e ka SELINË e saj në Peshkopi, në adresë: **Lagjja”Gjok Doçi”Pallati te ish Dega Ushtarake.**

Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është :

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është : **vellezerithysaI@yahoo.com**

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë degë, filiale, agjensi përfaqsimi dhe t’i suprimojë ato.

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të hapë njësi grumbulluese, përpunuese, shërbimi e tregtimi, duke bashkëpunuar me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj.

KREU I II

KAPITALI I REGJISTRUAR I SHOQËRISË

Neni 5

VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TE REGJISTRUAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është **6.000.000,00 Lek** i përbërë nga *kuotat e Ortakut të Vetëm Themelues*. Kapitali themeltar i shoqërisë është i formuar tërësisht nga kontributi në masën 100% i Ortakut të Vetëm Themelues.

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë përbehet nga kontributi i Ortakut të Vetëm Themelues dhe përbëhet nga kontributi në natyrë dhe kontributi në para në vlerën **6.000.000,00 Lek Lek**. Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë është **100%**.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar (Vlera e paguar) është **6.000.000,00 Lek Lek**.

Kontributet në Para janë paguar plotësisht me kontributin e Ortakut të Vetëm sipas raportit të paraqitur nga eksperti vlerësues i licencuar, me **CN-576156 datë 23/07/2011**.

Pagesat e kontributeve në Para janë kryher në llogarinë **Nr.420066882** pranë degës së **“B K T - BANK”** - Peshkopi.

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhëve dhe pasardhësve. Të gjitha pjesët e



HPK
TEL
1823440
DIBER

kapitalit të shoqërisë mund të kalojnë tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me Vendim të Ortakut të Vetëm Themelues dhe me Akt Noterial.

Trashëgimtari hyn në shoqëri me të gjitha të drejtat e Ortakut dhe për të gjitha efektet juridike.

Kapitali themeltar prej **6.000.000,00 Lek** ndahet në **100 pjesë, secila me vlerë nominale prej 60.000,00 Lek** dhe Ortaku i Vetëm Themelues **Artan HYSA** është zotërues i **100%** të këtyre pjesëve të nënshkuara e të paguara.

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga Ortaku i Vetëm Themelues. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

Neni 6

KËRKESA PËR TË PAGUAR KUOTAT DHE TËRHEQJA E KUOTAVE TË PAPAGUARA

1 – Administratori mund t'i kërkojë Ortakut të Vetëm të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tij dhe Ortaku i Vetëm (Pas marrjes së njoftimit prej **14 ditësh të plota** në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

2 – Zotëruesit e përbashkët të **një kuote** do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

3 – Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

4 – Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojë paraprakisht të paktën **14 Ditë të Plota** personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundëshme shtesë të kamatvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimi se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.

5 – Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e njoftuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumën e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

6 – Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratori e konsideron të Përshtatshme.

7 – Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e Ortakut në lidhje me këtë kuota por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyeshin nga ky Ortak ndaj shoqërisë në datën anulimit të kuotës së bashku me kamatvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.





Neni 7

LLOJET E KUOTAVE, TE DREJTAVE DHE KUFIZIMEVE

Në përputhje me dispozitat e ligjit dhe pa cënuar të drejta që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në Vendimin e Ortakut të Vetëm, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit Nr.9901, Date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 8

ÇERTIFIKATA E KUOTAVE

Secili Ortak ka të drejtë të përfitojë një **ÇERTIFIKATË** për kuotën e zotëruar prej tij.

Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikate për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorzimi i çertifikates ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorzim i kryer ndaj të gjithë zotëuesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në **çertifikatën e kuotës**. Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9

MËNYRAT E FITIMIT DHE TË KALIMIT TË KUOTAVE

I – Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjsi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a – Kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b – Shitblerjes,
- c – Trashëgimisë
- ç – Dhurimit
- d – Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2 – Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3 – Kuota e kapitalit të shoqërisë janë të transferueshme në rrugë trashëgimie. Trashëgimtari, parardhësi ose pasardhësi, bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të kuotave të kapitalit.

Neni 10

ZMADHIMI DHE ZVOGLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1 - Mbledhja e Ortakut të Vetëm, me **Vendim** të Ortakut të Vetëm, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakut ekzistues në shumën e pëcaktuar me vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

2 – Shoqëria mund të vendosë zvoglimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Ortakut të Vetëm të shoqërisë.





Neni 11

BLERJA E KUOTAVE TË VETA

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja, vetëm nese shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori apo Administratorët lëshojnë një **CERTIFIKATË** të aftësisë paguese të parashikuara nga ky nen.

Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

K R E U III

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI NE SHOQËRI

Neni 12

ORGAN VENDIMOR JANË :

- Vendimet e Ortakut të Vetëm që zëvendësojnë Asamblenë e Ortakëve.
- Ortaku i Vetëm ka të gjitha të drejtat që ka asambleja e Ortakëve.
- Ortaku i Vetëm vendos për çështje të tilla si : shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimin e raporteve të raporteve të administrimit dhe kontrollon miratimin e llogarive, ndryshimet në statut, zvoglimin e kapitalit themelor ose zmadhimin e tij, transferimin e pjesëve të kapitalit themelor tek të tretët, kryerjen e veprimtarisë për likuidimin e shoqërisë, shndrrimin e shoqërisë në formë tjetër të parashikuar nga ligji, ndryshimin e selisë së shoqërisë etj.

Neni 13

Ortaku i Vetëm i bën mbledhjet e zakonshme çdo vit brenda katër muajve nga mbyllja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë.

A D M I S T R A T O R I

Neni 14

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Artan HYSA.

- Administratori qëndron në detyrë për një periudhë pesëvjeçare (5) me të drejtë ripërtëritje, duke filluar afatin e qëndrimit në detyrë që me datën 10.10.2011 deri me datën 10.10.2016
- Mandati i Administratorit mund të jetë i rinovueshëm. Ortaku gëzon të drejtën që në çdo kohë të shkarkojë nga detyra administratorin dhe të emërojë një tjetër në vend të tij.
- Administratori mundet që në çdo moment të emërojë një zëvendës, ta revokojë atë dhe të emërojë një tjetër në vend të tij.





Neni 15

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

ADMINISTRATORI KA TË DREJTË E DETYROHET TË :

- a) – Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga mbledhja e Ortakut të Vetëm të shoqërisë,
- b) – Të përfaqsojë shoqërinë tregtare,
- c) – Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- ç) – Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara mbledhjes së Ortakut të Vetëm për miratim,
- d) – Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- dh) – Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për QKR (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit).
- e) – Të raportojë përpara Mbledhjes së Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
- ë) – Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në Ligj dhe në Statut

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Ortakut të Vetëm, në rastet kur :

--- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.

--- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se **5% (përqind)** të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

--- Shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se **5% (përqind)** të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Paditë që lidhen me shpërblimin e Administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16

PËRFAQSIMI

1 – Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të Administratorit i kundërvihen palëve të treat, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit Nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

2 – Tagrat e përfaqësimit të Administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë QKR (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit).

3 – Administratori nuk mund t'i delegojë detyrimet e tij ligjore.

Neni 17

SKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORIT

DETYRA E ADMINISTRATORIT PËRFUNDON NË RAST SE :

1 – Personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikes 6 të nenit 95 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008.

2 – Personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese.

3 – Personi vuan ose mund të vuajë nga ç'rregullime mendore.



- 4 – Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose...
- 5 – Personi ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Ortakut të Vetëm të shoqërisë në Mbledhjet e Ortakut të Vetëm të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe, Mbledhja e Ortakut të Vetëm vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 18

SHPËRBLIMI, PËRFITIMET E TJERA DHE SHPENZIMET E ADMINISTRATORIT

1 – Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Mbledhja e Ortakut të Vetëm në përputhje me parashikimet e nenit 77 të ligjit Nr.9901 Datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

2 – Mbledhja e Ortakut të Vetëm mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose në shoqëri parardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en) ose persona të tjerë të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajnë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

3 – Administratorit mund t'i paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjet e tij në mbledhjet e Ortakut të Vetëm ose në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij

Neni 19

PROCESVERBALET E MBLEDHJEVE TË ADMINISTRATORIT

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e :

- 1 – Të gjitha takimeve të kryera prej tij
- 2 – Të gjitha mbledhjeve të Ortakut të Vetëm të shoqërisë

K R E U I I V

DIVIDENTËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 20

DIVIDENTËT

1 – Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit Nr.9901, shoqëria me Vendim të Ortakut të Vetëm mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të përcaktuara me ligj.

2 – Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi. Në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

3 – Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

4 – Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda 12 (dymbëdhjetë) vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Mbledhja e Ortakut të Vetëm, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.




**VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, REZERVA E
DOMOSHËMË, KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR**

Neni 21

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar të çdo viti dhe përfundon 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë ku si fillim është data e regjistrimit të shoqërisë.

Neni 22

Llogaritë vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët apo nga ekspertët kontabël miratohen nga Ortaku i Vetëm. Miratimi i dokumentave financiarë vjetorë bëhet brenda një afati tre (3) mujor të mbylljes së vitit financiar.

Neni 23

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit mund të krijohë dhe fonde të tjera.

Administratori pas vendimit të marrë nga Mbledhja e Ortakut të Vetëm, duke patur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit Nr 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e paspërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividende preferenciale apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së sigurimeve shoqërore e shëndetsore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likujduese pranë çdo banke brenda vendit dhe të kryejë veprime likuidimi me to.

**K R E U I V
MARËDHËNIET E PUNËSIMIT DHE LIDHJA E KONTRATAVE**

Neni 24

Marëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në përputhje me Ligjin Nr.7961 Datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", si dhe legjislacionit tjetër shqiptar që bën fjalë për punësimin.

Neni 25

Marrja në punë bëhet me regjistrimin nga punëdhënësi në librin e punës së shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet kompetente në fushën e punësimit të juridiksionit ku ushtron veprimtarinë shoqëria.

Neni 26

Largimi nga puna bëhet me mbarimin e kontratës së punës ose përpara mbarimit të afatit të kontratës, për shkelje disiplinore ose me vetë kërkesën e punëmarrësit .
Largimi nga shoqëria bëhet pasi janë shlyer të gjitha detyrimet materiale dhe monetare.
Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti të shkruar të lëshuar nga Ortaku i Vetëm Themelues.





Neni 27

Shoqëria mund të lidhë kontrata me ente shtetërore dhe persona fizikë e juridike, vendas ose të huaj.

Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqsohet nga Ortaku i Vetëm i saj, ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij me prokurë.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë.

K R E U I VI PRISHJA DHE NJOFTIMET

Neni 28 PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Shoqëria hyn në procesin e likujdimi që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likujdatorë të cilët ndjekin operacionet e likujdimi deri në fund dhe i paraqesin Ortakut të Vetëm dhe Administratorit rezultatet përfundimtare të likujdimi. Në përfundim mbledhje e Ortakut të vetëm vendos për heqjen e mandatit të tyre. Të gjitha detyrimet që dalin nga likujdimi, Ortaku i Vetëm merr përsipër që t'i shlyejë me kapitalin e tij.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PRISHET :

- a) – Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në thenelimin e saj.
- b) – Me vendim të Ortakut të Vetëm.
- c) – Me hapjen e procedurave të falimentimit.
- ç) – Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",
- d) – Me vendim të gjykatës kompetente.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimi në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Rregullat për procedurën e zakonshme të likujdimi në gjendjen e aftësisë paguese, janë përcaktuar në nenet 191 dhe 203 të Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 29 NJOFTIMET

1 - Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pike 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

2 – Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratori në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të 137 këtij Statuti.



Neni 30

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë ato do të zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 31

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë ato do të zgjidhen në rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 32

Transferimi shoqërisë nga një formë në një tjetër bëhet me Vendim të Ortakut të Vetëm, kur plotësohen kushtet për krijimin e shoqërive të llojeve të tjera.

Neni 33

Themeluesi i shoqërisë mund të bëjë ndryshime e plotësime në Statut dhe Aktin e Themelimit pa rënë ndesh në mënyrë thelbësore në çdo kohë me nenet e përshkruara në këtë Statut.

Ndryshimet e plotësimet bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën hartohet vetë Statuti.

Neni 34

Për çështjet e tjera që nuk janë hartuar në këtë Statut, shoqëria do t'i referohet në çdo kohë Ligjit Nr. 9901 Datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 35

Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

Peshkopi, 10.10.2011

ORTAKU I VETËM THEMELUES DHE ADMINISTRATOR
I SHOQËRISË "VËLLEZËRIT HYSA" - SH.P.K

Artan Hysa

